



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), e mbajtur më 19.01.2023, me fillim në ora 10:00
Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit **Defrim Kafexhiu**.
Kryesuesi – Fillimisht, përshëndetje për të gjithë. Përshëndetje nënkryetar **Fatmir Iska**. Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorë të drejtorive, zyrtarë komunal, përfaqësues të KFOR-it, të gjithë ju të pranishëm! Valeminderit shumë për pjesëmarrjen. E hapim mbledhjen e parë (1) të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2023
Në konsultim me kryetarin e komunës kemi përgatitur këtë rend dite;

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për Transparencë Komunale 2023-2027;
3. Shqyrtimi i Planit Komunal të Veprimit për të Zhvendosurit dhe Zgjidhje të Qëndrueshme në komunën e Rahovecit;
4. Shqyrtimi Raportit Financiar për vitin 2022;
5. Shqyrtimi i plotësim-ndryshimit të Rregullores për Taksa 01 Nr.51/20 të datës 28.02.2020;
6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-01240-0 në zonën kadastrale Retijë;
7. Raporti për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm sipas Planit të Veprimit për vitin 2022;
8. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-05864-0;
9. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-07111-1;
10. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës – P-00251-0;
11. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-03710-0;
12. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-03818-0 dhe P-03819-0;
13. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-02352-0;
14. Shqyrtimi i Raportit të Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2022;
15. Shqyrtimi i Raportit të Punës të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2022;
16. Shqyrtimi i Informatës rreth aktiviteteve të KKS-së për vitin 2022;
17. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2022;
18. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për vitin 2022;
19. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Komitetit për Arsimit për vitin 2022;
20. Të ndryshme.

Kryesuesi – Atëherë nëse dikush prej anëtarëve ka ndonjë gjë lidhur me rendit të ditës?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është për?... Me shumicë votash aprovohet rendi i ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi – A dikush diçka lidhur me procesverbalin?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Me shumicë votash aprovohet procesverbali i mbledhjes së kaluar.

2. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për Transparencë Komunale 2023-2027;

Kryesuesi – Atëherë, materialin e planit e keni afër të gjithë, gjithashtu e keni shqyrtuar. Është e rëndësishme që ta kalojmë menjëherë për në kuvend. Kush është për?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e dytë.

3. Shqyrtimi i Planit Komunal të Veprimit për të Zhvendosurit dhe Zgjidhje të Qëndrueshme në komunën e Rahovecit;

Lendrit Qeli – Faleminderit kryesues, të nderuar të pranishëm. E keni edhe materialin e këtij plani. Plani nuk ka komplikime buxhetore, ndërsa edhe pjesa tjetër administrative që e ka për obligim ZKKK-ja është në konform të këtij plani.

Kryesuesi – Faleminiderit Lendrit. Dikush ndonjë koment?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është për?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e tretë.

4. Shqyrtimi Raportit Financiar për vitin 2022;

Afrim Limani – Faleminderit. Të nderuar anëtarë të KPF-së, të gjithë të pranishmit. Ju kërkoj falje për vonesë sa i përket dorëzimit të raportit sepse pardje jemi barazuar me ministrinë e financave duke punuar deri në orët e vona, në mënyrë që të paktën ta keni raportin para mbledhjes së KPF-së.

Në këtë raport janë të përfshiera të gjitha ngjarjet dhe aktivitetet finaciare në mënyrë analitike në të gjitha kategoritë ekonomike. Të hyrat e rregullta për këtë vit në total janë 1.256.000. Prej 84.000euro kemi një ndryshim pozitiv nëse bëjmë krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Shpenzimi i buxhetit ka shkuar në përqindje prej 95.10%.

Kryesuesi – Faleminiderit drejtor. A ka dikush prej anëtarëve ndonjë koment?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është për?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e katërt.

5. Shqyrtimi i plotësim-ndryshimit të Rregullores për Taksa 01 Nr.51/20 të datës 28.02.2020;

Erhan Morina – Faleminiderit kryesues. Të nderuar anëtarë të KPF-së, para jush keni propozimin për plotësim ndryshimin e rregullores Nr. 80/20 (taksa dhe tarifa). Ky plotësim-ndryshim ka ardhur si nevojë e ndryshimit të tarifave me udhëzim administrativ për gjeodezi kadastrë dhe pronë.

Kryesuesi – Faleminiderit drejtor. Kush është për?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e pestë. Vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës, më pas kthehemi, sepse i njëjti drejtor do t'i prezantoj disa pika.

7. Raporti për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm sipas Planit të Veprimit për vitin 2022;

Afrim Limani – Auditimi i pasqyrave financiare të komunës së Rahovecit për vitin 2022 ka dalur me 14 rekomandime. Si rezultat i kësaj, menjëherë e kemi formuar një komision për zbatimin e këtyre rekomandimeve dhe kemi zhvilluar shumë takime duke analizuar se 7 rekomandime do të zbatohen plotësisht dhe 7 të tjera pjesërisht.

Kryesuesi – Faleminnderit drejtor. A ka dikush prej anëtarëve ndonjë koment?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është për?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e shtatë e rendit të ditës. Po kthehemi te pika e gjashtë si dhe pika: 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13 do të prezantohen nga drejtori Afrim Oruqi dhe do t'i vendosim të gjitha në votim.

6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-01240-0 në zonën kadastrale Retijë;

8. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-05864-0;

9. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-07111-1;

10. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës – P-00251-0;

11. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-03710-0;

12. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-03818-0 dhe P-03819-0;

13. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-02352-0;

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues. Sipas ligjeve në fuqi keni propozimin e kryetarit të komunës për shpalljen me interes të përgjithshëm të një parcele në zonë kadastrale në Retijë, prona është e NBI-së dhe rmenaxhohet prej AKP-së. Bëhet fjalë për 23 ari e 12 metra katror, si qëllim është shpronësimi i parcelës. Ftoj anëtarët e KPF-së që ta votojnë pikën e 6-të.

8. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-05864-0;

Afrim Oruqi - Para jush keni vendimin për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për vlerësim të ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës. Bëhet fjalë për pronën komunale, ku komisioni ka përbërje prej 2 anëtarë të ekzekutivit, 2 të kuvendit dhe një nga sektori joqeveritar. Bëhet fjalë për parcelën nr.05864-0. Te pika e 9-të e rendit të ditës bëhet fjalë për parcelën me nr. 07111-1. Te pika e 10-të e rendit të ditës, bëhet fjalë për parcelën 00251-0. Te pika e 11-të e rendit të ditës, bëhet fjalë për parcelën me nr. 03710-0. Te pika e 12-të e rendit të ditës, bëhet fjalë për dy parcela; P-03818-0 dhe P-03819-0. Te pika e 13-të bëhet fjalë për parcelën me nr. 02352-0. Të gjitha këto parcela do të jepen me qera dhe për secilën parcelë po kërkojmë prej juve që të merrni vendim për formimin e komisionit për dhënien e këtyre parcelave me qera.

Kryesuesi – Faleminiderit drejtor. A ka dikush ndonjë koment rreth pikave të prezantuara nga drejtori?... Nëse jo, atëherë po i vendosim në votim pikat: 6, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13. Kush është për?... Me shumicë votash aprovohen këto shtatë pika të rendit të ditës, e që në seancën e rregullt të kuvendit komunal do të diskutohen veç e veç.

14. Shqyrtimi i Raportit të Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2022;

Kryesuesi – Besoj që secili prej anëtarëve e keni raportin raportin e punës së kuvendit, jem munduar t'i paraqesim të gjitha aktivitetet e vitit të kaluar. Raporti ka për qëllim rritjen e transparencës dhe llogaridhënien e kuvendit të komunës së Rahovecit, karshi qytetarëve. Atëherë nëse dikush nuk ka ndonjë koment rreth raportit të punës së kuvendit, po e vendosim në votim. Kush është për?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e 14-të e rendit të ditës.

15. Shqyrtimi i Raportit të Punës të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2022;

Kryesuesi – Në mungesë të dikujt për ta prezantuar raportin i cili mund të plotësohet edhe më shumë, në seancën e rregullt zyrtari do të jetë i pranishëm. Po e vendosim në votim, kush është për?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e 15-të.

16. Shqyrtimi i Informatës rreth aktiviteteve të KKSB-së për vitin 2022;

Nora Boshnjaku – I nderuar kryesues, nënkryetar, anëtarë të KPF-së, para vetes e keni informatën lidhur me aktivitetet që KKSB ka zhvilluar gjatë vitit 2022. Kjo informatë ka për qëllim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies karshi qytetarëve.

Kryesuesi – Faleminderit drejtoresh. A ka dikush ndonjë koment rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e 16-të.

17. Shqyrtimi i Raportit të Punës se Komitetit për Komunitete për vitin 2022;

18. Shqyrtimi i Raportit të Punës se Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për vitin2022;

19. Shqyrtimi i Raportit të Punës se Komitetit për Arsimit për vitin 2022;

Kryesuesi - Asnjëri prej kryesuesve të komiteteve të lartëpërmendura nuk është prezent sot në mbledhje për ta prezantuar raportin e tyre. Do t'iu përcjelli nga një vërejtje atyre dhe kisha kërkuar këto tre pika t'i përcjellim për në kuvend. Kush është për?... Me shumicë votash aprovohen këto tre pika.

20. Të ndryshme;

Kryesuesi – Jemi në pikën e fundit. Nëse dikush prej anëtarëve të KPF-së ka diçka për të thënë ose ka ndonjë kërkesë?... Nëse jo, atëherë po e mbyllim edhe këtë mbledhje. Faleminderit për mirëkuptimin e juaj, poashtu të KFORI-it dhe OSBE-së dhe më lejoni të iu ngushëllojë me rastin e vdekjes së dy veprimtarëve – veteranëve të luftës së UÇK-së, Sabahajdin Cena dhe Vehbi Jupa. Faleminderit, shihemi në seancën e rregullt.

Mbledhja përfundoi: 10:35

Procesmbajtësi;


Albjon Krasniqi

